

INFORMACIONE TË SHKURTRA MBI

Ndryshime në sigurimin shëndetësor të "NY State of Health" gjatë emergjencës së Koronavirusit



Mos u largoni pa mbulim të sigurimit shëndetësor.


"NY State of Health" është tregu zyrtar i planeve shëndetësore të Nju-Jorkut.

Jemi këtu për t'ju ndihmuar.

Aplikoni tani.

 Në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov

 Me telefon në numrin 1-855-355-5777
TTY 1-800-662-1220

 Lidhuni me një ndihmës të Regjistrimit në adresën info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

Të kesh sigurim shëndetësor është thelbësore. Tani më shumë se kurrë.

"NY State of Health" ka marrë masa të ndihmojë nju-jorkezët që nuk kanë mbulim të sigurimit shëndetësor apo që po humbasin mbulimin e sigurimit shëndetësor të punëdhënësit.

Pyetjet më të shpeshta

Ndryshime të të ardhurat dhe humbja e mbulimit të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit:

Çfarë duhet të bëj nëse kam humbur mbulimin e sigurimit shëndetësor të punëdhënësit tim apo nëse nuk mund ta përballoj "COBRA" të ofruar nga punëdhënësi im?

- Ju mund të keni të drejtë për ndihmë për të paguar mbulimin e sigurimit shëndetësor nëpërmjet "NY State of Health" ose mund të keni të drejtë për mbulim falas.
- Mos prisni për të aplikuar. Duhet të aplikoni brenda 60 ditëve nga humbja e mbulimit të sigurimit shëndetësor për t'u siguruar që jeni në gjendje të regjistrohni në mbulimin për këtë vit.

Çfarë duhet të bëj nëse të ardhurat e mia kanë ndryshuar dhe jam tashmë i regjistruar për mbulim të sigurimit shëndetësor nëpërmjet "NY State of Health"? A mund të marr më shumë ndihmë për të paguar mbulimin tim?

- Mund të keni të drejtë për të paguar mbulimin tuaj. Përditësoni llogarinë tuaj me të ardhurat tuaja të reja brenda 60 ditëve nga ndryshimi. Mund të kualifikoheni për më shumë ndihmë financiare që mund të ulë koston e mbulimit tuaj.

Ndryshime në sigurimin shëndetësor të "NY State of Health" gjatë emergjencës së Koronavirusit

Çfarë është Dekreti Ndhma e Koronavirusit, Lehtësimi dhe Siguria Ekonomike (Coronavirus Aid, Relief and Economic Security (CARES) Act)?

Dekreti Ndhma e Koronavirusit, Lehtësimi dhe Siguria Ekonomike (Coronavirus Aid, Relief and Economic Security (CARES) Act) u kalua nga Kongresi dhe u nënshkrua si ligj nga presidenti Trump më 27 mars të 2020. Kjo paketë lehtësuese ekonomike prej \$2.2 trilion u miratua për të mbrojtur popullin amerikan nga impaktet ekonomike dhe në shëndetin publik të COVID-19. Dekreti CARES Act siguron asistencë ekonomike për punëtorët, amerikanë, familjet dhe bizneset e vogla dhe synon të ruajë vendet e punës për industrinë amerikane.

Pagesat e reja të të ardhurave federale/Kompensimi i papunësisë gjatë COVID:

Kam marrë një pagesë nga Dekreti federal CARES Act (referuar përgjithësisht si një pagesë stimuluese). A llogaritet kjo shumë si e ardhur në aplikimin tim të "NY State of Health"?

- Jo. Pagesa stimuluese nuk llogaritet si e ardhur për ndonjë nga përdoruesit e "NY State of Health". Përdoruesit përfitues do të marrin një pagesë të vetme nga Departamenti i Thesarit i Sh.B.A. Këto pagesa do të shpërndahen bazuar në një ligj të ri federal, njohur si Dekreti CARES Act, miratuar si përgjigje ndaj pandemisë së COVID-19. Përdoruesit përfitues do të marrin një pagesë të vetme prej \$1,200 për çdo të rritur dhe \$500 për çdo fëmijë.

Jam duke marrë nga shteti Pandemic Unemployment Compensation si shtesë së përfitimeve të rregullta të papunësisë time. A e raportoj atë si të ardhur kur të aplikoj për sigurim shëndetësor nëpërmjet "NY State of Health"?

- Kjo varet nga ju. Pandemic Unemployment Compensation së Pandemisë (\$600 në javë) llogaritet si e ardhur për disa të regjistruar të "NY State of Health", por jo për të tjerët.
- Raportoni Kompensimin tuaj të Papunësisë së Pandemisë (Pandemic Unemployment Compensation) nëse:
 - Ju nuk keni fëmijë* në shtëpinë tuaj DHE
 - Të ardhurat tuaja vjetor janë më shumë se \$25,520 për një individ të vetëm ose \$34,480 për një çift.
- Mos e raportoni Kompensimin tuaj të Papunësisë së Pandemisë (Pandemic Unemployment Compensation) nëse:
 - Keni fëmijë.*
 - Të ardhurat tuaja të pritshme vjetore janë më pak se \$25,520 për një individ të vetëm ose \$34,480 për një çift.
- Nëse duhet të përditësoni aplikimin tuaj për të shtuar si të ardhur Pandemic Unemployment Compensation, ndihmësit e "NY State of Health" dhe Shërbimi ndaj Klientit janë në dispozicion për t'ju ndihmuar të plotësoni aplikimin tuaj.

*Shprehja "fëmijë" nënkupton një fëmijë nën 19 vjeç ose 19 dhe 20 vjeç nëse është një student me kohë të plotë.

Ndryshime në sigurimin shëndetësor të "NY State of Health" gjatë emergjencës së Koronavirusit

Periudhat e lehtësimit dhe Pagesa për Mbulim:

Po regjistrohem në Essential Plan (EP) dhe kam një këst \$20 në muaj. A duhet ta paguaj këstin tim të parë brenda 10 ditësh që të më fillojë mbulimi?

- Gjatë periudhës së emergjencës së Koronavirusit, planet shëndetësore do të mundësojnë një periudhë më të gjatë kohore për të bërë pagesën tuaj të parë. Duhet të flisni me planin shëndetësor ku jeni regjistruar.

Po regjistrohem në një "Qualified Health Plan (QHP)". A duhet ta paguaj këstin tim të parë brenda dhjetë ditësh që të më fillojë mbulimi?

- Po. Të gjithë të regjistruarit në QHP, përfshirë ata që paguajnë këstin e plotë dhe ata që marrin kredite paraprake tatimore të këstit (APTC), u kërkohet të bëjnë pagesën e tyre të parë të këstit në mënyrë që të fillojë mbulimi i tyre. Disa plane mund ta shtyjnë periudhën 10-ditore. Duhet të flisni me planin shëndetësor ku po regjistroheni.

Jam regjistruar tashmë në një "Qualified Health Plan" dhe po marr ndihmë për të paguar për mbulimin tim me APTC-të. Për sa kohë duhet t'i paguaj këstet e mia mujore?

- Gjatë periudhës së emergjencës së Koronavirusit, periudha kohore që duhet të paguani për mbulimin tuaj mujor, e quajtur "periudha e lehtësimit", është zgjatur nga 90 ditë në 120 ditë. Nuk keni nevojë të demonstroi se keni probleme financiare për t'u kualifikuar për periudhën e zgjatur të lehtësimit. Fatura që merrni nga plani juaj shëndetësor do t'ju tregojë datat e pagesave.
- Nëse nuk paguani këstet tuaja gjatë periudhës së lehtësimit prej 120 ditësh, plani juaj shëndetësor mund të përfundojë mbulimin tuaj në ditën e 60-të të periudhës së lehtësimit dhe ju nuk do të keni mbulim për shërbime që keni marrë pas asaj date dhe mund të mos jeni në gjendje të merrni mbulim për pjesën e mbetur të vitit, përveç nëse keni një ngjarje kualifikuese jetësore që shkakton një Periudhë Speciale të Regjistrimit (SEP).
- Nëse keni probleme të paguani për mbulimin tuaj, kontaktoni "NY State of Health" ose flisni me planin tuaj shëndetësor. Mund të ketë të tjera alternativa më të përballueshme për ju.
- **Shënim:** NYS Department of Financial Services ka nxjerrë [udhëzues](#) për individët që paguajnë këste të plota për mbulim. Vërtetimi i vështirësive nga COVID-19 kërkohet për këtë popullatë: